

TRASHËGIMIA KULTURORE, BURIM PËR ANGLISHTEN PËR QËLLIME SPECIFIKE NË FUSHËN E TURIZMIT

Dr. DEMIR KROJ

Filiali Sarandë
Universiteti i Tiranës
demirkroi@yahoo.co.uk

Msc. VASIL BARKA

Filiali Sarandë
Universiteti i Tiranës
vasil.barka@gmail.com

ABSTRACT

This paper presents a project based on the use of cultural heritage elements as resources or contexts to foster students' oral communication skills in English. It aims at developing English ability of young learners of Saranda region in order to promote local cultural sites to be prime tourism destination. Its main objective is to help students improve their oral communication level in English, learn about the cultural heritage of the area, develop a taste and an appreciation for art, creativity, history and cultural heritage and even foster students' and teachers' motivation. It emphasizes practicing communicative speaking skills in the implementation of ESP for tourism. Most of the activities were carried out in non-formal environment such as museums, national parks or historical buildings. The methodology used in the research of this project made it possible to effectively assess and validate its design. This qualitative research is based on the principles of planning, action, observation and reflection. The criteria used to test speaking ability were fluency, pronunciation, grammar and vocabulary. Combining relevant knowledge about local culture heritage and ESP will only provide more potential for tourism and most importantly, more qualitative and sustainable tourism for our region.

Keywords Oral skills in ESP English, Improvement, Cultural Heritage, Learning in Non-formal Environment.

1. Hyrje

Rowe & Humphries¹ (2012) e konsiderojnë mësimdhënien si sistem vlerash të duhura që duhet të rrënjohet tek fëmijët për të ardhmen e tyre dhe besojnë se procesi edukativ nuk ndodh vetëm përmes mësimi, por edhe ndërveprimit me gjallesat e tjera. Çdo person duhet të rritet me ndjenjën se është anëtar aktiv i një grupi ku gjuha është faktor themelor i ndërveprimit. Ky besim pasqyron rëndësinë e ndërveprimit në proceset e mësimdhënies dhe të nxënës, lidhur ngushtë me idetë e Vygotskit² (1986).

Në rastin e Shqipërisë, mungesa e zhvillimit të kompetencës së komunikimit në gjuhët e huaja është e dukshme. Qasjet tradicionale të mësimdhënies së gjuhës fokusohen kryesisht në gramatikë dhe fjalor dhe rrallë promovojnë të folurin. Prandaj, nevojitet ndryshim metodologjik në vend që shumë mësues të marrin trajnim të veçantë në mësimdhënien mbi aftësitë në të folur.

Iniciativat si projekti këtu janë shembull si të promovohen aftësitë e të folurit. Të mësuarit jashtë klasës nënkupton të mësuarit në mjedise joformale, gjë që nxit motivimin. Përdorimi i trashëgimisë kulturore si burim ose kontekst nënkupton përvoja të paharrueshme, ku arti dhe trashëgimia bëhen të pandashme nga aftësitë e të folurit.

Ky projekt lindi nga kërkimi i një perspektive aktuale në Universitetin e Tiranës, Filiali Sarandë. Ai promovon komunikimin gojor në orën e anglishtes duke përdorur trashëgiminë kulturore si burim ose kontekst për të mësuar. Vizita në muze, ndërtesa historike, vende arkeologjike dhe vende të ngjarjeve kulturore u kryen për të nxitur të mësuarit në një mjedis joformal.

Projekti filloi në universitet, me programet e trajnimit të mësuesve dhe njëherazi, disa përvoja u vunë në praktikë në disa shkolla të Sarandës. Zbatimi i projektit në nivelin e arsimit të mesëm dhe universitar bashkë me hulumtimin dhe vlerësimin ndihmuan në përmirësimin e propozimit fillestar.

Të mësuarit përmes konteksteve të trashëgimisë prodhon procese perceptimi dhe lejon nxënësit të shprehin emocione, të marrin

¹ S. Rowe, S. Humphries. The Coombes approach. Learning through an experimental and outdoor curriculum, Continuum, London, 2012.

² L. S. Vygotski. Thought and language, Harvard University Press, Cambridge, 1986.

vendime, të shprehin pikëpamje, të zhvillojnë punë bashkëpunuese e të promovojnë aktivitete ndërkurrikulare. Nëse këto procese mësimore zbatohen në fushën e gjuhëve të huaja, bëhet e mundur praktika e pakufizuar e aftësive të të folurit. Nxënësit kërkojnë përvoja që kanë diçka për të ndarë, ata kënaqen duke pasur diçka për të folur dhe mundësinë për të shprehur mendimet e tyre. Për këto arsye, përdorimi i trashëgimisë si burim ose kontekst ofron situata autentike ku pjesëmarrësit fillojnë dialog, ndajnë ndjesi, shprehin ndjenja dhe shkëmbejnë mendime.

Të mësuarit jashtë klasës është shtylla tjetër e rëndësishme ku mbështetet ky projekt. Në këtë projekt nxënësve iu dha mundësia të dalin nga klasa për të njohur trashëgiminë përreth dhe të ushtrojnë aftësitë e të folurit në anglisht. Ky mjedis joformal, sipas Asensio³ (2015), ofron rezultate më të mira të të mësuarit sesa ai formal. Sidoqoftë, kjo ide bie ndesh me qasjet tradicionale të mësimdhënies së gjuhës, të cilat janë ende në përdorim kudo, që këmbëngulin në përdorimin e klasave të duhura.

Një shqetësim aktual lidhur me promovimin e vendeve kulturore si destinacione turistike është përdorimi i gjuhës së folur për të informuar e shpjeguar gjërat në lidhje me vendet kulturore. Për turistët nevojitet që stafi i turizmit të zotërojë anglishten si gjuhë ndërkombëtare. Duke rritur aftësinë në anglisht për të promovuar vendet kulturore të Shqipërisë, turistët e huaj kuptojnë më lehtë dhe ulet niveli i keqkuptimeve mes stafit dhe turistëve.

2. Shqyrtimi i literaturës

2.1 Anglishtja për Qëllime Specifike (AQS)

Hutchinson dhe Waters⁴ (1987) treguan se “AQS është një qasje ndaj mësimi të gjuhës në të cilën të gjitha vendimet për përmbajtjen dhe metodën bazohen në arsyen e të mësuarit të nxënësit. Strevens⁵ (1988) e përshkruan AQS si mësimdhënie që është krijuar për të përmbushur

³ M. Asensio. El aprendizaje natural, la mejor vía de acercarse al patrimonio, *Educatio Siglo XXI*, 33 (1), f. 55-82, 2015.

⁴ Hutchinson, T & Waters, A. (1987). *English for Specific Purposes*. New York: Cambridge University Press.

⁵ Strevens, P. (1988). ESP after twenty years: A re-appraisal. In M. Tickoo (Ed.), *ESP: State of the art* (f. 1-13). SEAMEO Regional Language Centre. Cambridge University Press.

nevojat specifike të nxënësit. AQS është një emër i përgjithshëm për gjithë llojet e anglishtes, përveç anglishtes së përgjithshme, si anglishtja për qëllime akademike, anglishtja për infermierë, anglishtja për avokatë, anglishtja e biznesit, anglishtja për turizëm etj.

Një përkufizim i AQS thotë se “AQS bazohet në hartimin e kurseve për të përmbushur nevojat e nxënësve” (Robinson⁶, 1991;). Në përgjithësi ajo përdoret për t’iu referuar mësimdhënies dhe mësimi të gjuhës së huaj për qëllim qartësisht utilitar. Përkufizime të tjera thonë se AQS përdor metodologjinë dhe aktivitetet themelore të disiplinës të cilës i shërben, dhe përqendrohet në gjuhën (gramatikë, leksik dhe regjistër), aftësitë, ligjërimin dhe zhanret e përshtatshme për këto veprimtari (Evans & St John⁷, 1998). Kjo tregon se materialet, programi dhe qëllimi i AQS duhet të hartohen dhe zhvillohen sipas nevojave të studentëve. Kështu, qasja AQS është një qasje nga poshtë lart. Lidhur me temat, mësimdhënia e anglishtes për turizëm, sipas Walker⁸ (1995), arrihet më mirë përmes fokusit të bazuar në tematikë. Kjo lloj qasjeje e dizajnit trajtohet në mënyrë korrekte, përmbush rolin e dyfishtë të ofrimit të një kuadri kuptimplotë brenda të cilit ata përmirësojnë aftësitë gjuhësore.

2.2 Anglishtja për Qëllime Turizmi (AQT)

Sipas Leslie dhe Russell⁹ (2006), të qenit i aftë në gjuhë të huaj është i nevojshëm për njerëzit që punojnë në sektorin e turizmit dhe mikpritjes. Në fakt, për ata që kërkojnë punësim në këtë industri është thelbësore që të qëndrojnë shumë të motivuar në mënyrë që të zotërojnë një nivel të lartë të gjuhës së shërbimit profesional.

Në fakt, anglishtja për qëllime turistike ndihmon për t’u pajisur me fusha specifike të aftësive dhe njohurive gjuhësore. Rrjedhimisht, përvetësimi i aftësive specifike në anglisht ndihmon në zbatimin e duhur të tyre në vendin e punës. Për shkak të kësaj, një nevojë e veçantë gjuhësore e kontekstit të specifikuar ka rol kritik si kërkesë

⁶ Robinson, P. C. (1991). *ESP Today: A Practitioner’s Guide*. New York. Prentice Hall.

⁷ Dudley-Evans, T & St. John, J.M. (1998). *Development in English for Specific Purposes*. Cambridge: Cambridge University Press.

⁸ Walker, Robin. “Teaching the English of Tourism”. IATEFL ESP SIG Newsletter no 4. November 1995.

⁹ Leslie, D., & Russell, H. (2006). The importance of foreign language skills in the tourism sector: A comparative study of student perceptions in the UK and continental Europe. *Tourism Management*, 27 (6), f.1397-1407.

për të zbatuar një gjuhë të suksesshme (Shieh¹⁰, 2012). Studentët tanë mësojnë anglisht për të folur me vizitorët që vijnë në vendin tonë, por ata nuk pritët të udhëtojnë në vendet e synuara dhe të mësojnë për kulturat e gjuhës së synuar. Arsyeja për këtë qasje mund të jetë nevoja që nxënësit të flasin për kulturën e tyre me vizitorët. Një arsye tjetër për marrjen në konsideratë të një materiali të tillë është të ndihmojmë studentët të ndërëgjegjësohen për identitetin e tyre kulturor.

2.3 Trashëgimia Kulturore

Ruajtja e trashëgimisë kulturore ndihmon zhvillimin e një kombi në vazhdimësi. Duke ruajtur dhe promovuar trashëgiminë kulturore ne kontribuojmë drejtpërdrejt ekonomikisht, përkatësisht në rritjen e këmbimit valutor të vendit përmes turizmit.

Nëpërmjet ruajtjes dhe prezantimit të trashëgimisë kulturore, brezi aktual sheh forcën dhe estetikën e të parëve të tij. Brezi i tanishëm mund të shohë forcën e paraardhësve të tij përmes trashëgimisë së tij. Pra, trashëgimia kulturore në mënyrë indirekte trashëgon vlera karakteristike që mund të jenë pasqyrë për brezin aktual.

Ligji Nr.11 i vitit 2010 për trashëgiminë kulturore neni 1, thotë se “Zhvillimi është rritje e vlerës potenciale, informimi dhe promovimi i Trashëgimisë Kulturore dhe përdorimi i saj nëpërmjet kërkimit, rivitalizimit dhe përshtatjes në mënyrë të qëndrueshme dhe jo në kundërshtim me qëllimin e ruajtjes”. Organizata Botërore e Turizmit e përkufizon turizmin e trashëgimisë si aktivitet për të shijuar historinë, natyrën dhe reliket e kulturës njerëzore, artit, filozofisë dhe institucioneve nga rajone të tjera. Turizmi i trashëgimisë është gjithashtu një takim personal me traditat, historinë dhe kulturën. Ai bazohet në konceptin se çdo komunitet ka një histori për të treguar.

3. Projekti

Ky projekt bazohet në përdorimin e burimeve të trashëgimisë në muze, ndërtesa historike, vende arkeologjike dhe mjediset e ngjarjeve kulturore. Vizita të veçanta u organizuan në varësi të përmbajtjes dhe

¹⁰ Shieh, W. (2012). Hotel employees’ perception on their workplace English use: An example from Taiwan. *US-China Foreign Language*, 10(11), f.1729-1733.

objektivave të planifikuara dhe ofertës së bërë nga çdo institucion dhe aktivitet kulturor i planifikuar.

3.1. Sfondi teorik

Ky projekt është një alternativë praktike dhe konstruktive ndaj modeleve tradicionale të mësimdhënies. Ai promovon ndërveprimin midis nxënësve, studentëve dhe mësuesve. Vygotski zhvilloi një teori mbi ndërveprimin, ku njerëzit bashkëveprojnë në mënyrë indirekte me mjedisin e tyre nëpërmjet instrumenteve ndërmjetësuese, duke përfshirë burimet kulturore, ku gjuha është pjesë e tyre. Vygotski e kupton gjuhën si mjet bazë që u siguron njerëzve njohje të botës. Prandaj, është e nevojshme të zgjerojmë kontaktet tona me njerëzit e tjerë, në kontekste të ndryshme, duke përjetuar situata të reja komunikuese. Sipas Vygotskit, kultura përkufizohet si përvoja sociale dhe materiale e akumuluar historikisht nga njerëzit. Qeniet njerëzore përdorin vepra kulturore, veçanërisht me ndihmën e gjuhës së folur dhe të shkruar dhe kështu, kultura është tejet e rëndësishme për përvetësimin e gjuhës.

3.2. Veprimtaritë dhe burimet

Të gjitha veprimtaritë e projektit ndajnë të njëjtat parime: promovimi i aftësive në të folur të studentëve për t'i ndihmuar ata në mësimin akademik dhe jetën shoqërore; të fokusojë aktivitetet në format gjuhësore, strukturën e të folurit dhe fjalorin për të zhvilluar aftësitë në të folur; për të mbështetur dhe forcuar ndërveprimin e nxënësve dhe inkurajuar dialogun krijues dhe diskutimet mes nxënësve dhe mësuesve. Aktivitetet u ndanë në: aktivitete në klasë dhe jashtë shkollës.

4. Metoda

Metodologjia në këtë hulumtim dha kohë për të vlerësuar dhe vërtetuar dizajnin e tij. Ishte një kërkim cilësor i bazuar në parimet e kërkimit të veprimit të Lewin: Planifikimi, veprimi, vëzhgimi dhe reflektimi. Teknikat e përdorura ishin vëzhgimi nga pjesëmarrësit e mospjesëmarrësve dhe një grup diskutimi. Projekti u zhvillua në disa

shkolla në Sarandë ku morën pjesë rreth 60 nxënës. Pjesëmarrësit ishin nxënës të shkollave të mesme, të diplomuar në universitet dhe disa të rinj të punësuar ose jo. Nxënësit u ndanë në grupe prej 10 vetash dhe disa nga mësuesit e gjuhës angleze dhe trashëgimisë kulturore të shkollës punuan me ta gjatë vizitave.

Projekti u vlerësua përmes vëzhgimit dhe një fokus grupi. Vëzhgimi i pjesëmarrësve u zhvillua gjatë vizitave përmes shënimeve në terren, fotografive dhe regjistrimeve me celular. Për të strukturuar informacionin e mbledhur u krijuan katër kategori analizash. Këto ishin: *Kontekstet*, *Ndërveprimi*, *Gjuha Angleze dhe Motivimi*. Informacioni në lidhje me kontekstet u mor nëpërmjet fotografive në terren, të cilat ndihmuan në përshkrimin e kontekstit dhe mjedisit. Nëpërmjet regjistrimeve audio dhe video, ndërveprimi ndërmjet nxënësve, nxënësve dhe mësuesve dhe mjedisve mund të analizohej përveç llojit të teksteve që studentët prodhuan dhe aspekteve gjuhësore si shqiptimi, intonacioni apo strukturat gramatikore.

Vëzhgimi i mospjesëmarrësve u krye nga një vëzhgues i jashtëm i cili përdori të njëjtat mjete si vëzhguesit pjesëmarrës dhe plotësoi modele të ndryshme. Në këtë rast, kategoritë e analizuara ishin të njëjta: kontekstet, ndërveprimi, gjuha angleze dhe motivimi.

Fokus-grupi ishte instrumenti tjetër për të vlerësuar projektin. Ai u organizua në Filialin Sarandë. Puna u realizua nga pedagogë të filialit dhe synimi ishte vlerësimi dhe vërtetimi i projektit. Ky fokus-grup kishte tre pedagogë dhe paraprakisht u krijuan katër kategori analizuese: *Komunikimi i folur*, *Të nxënit në mjedis joformal*, *Motivimi* dhe dy kategori të tjera: *Vlerësimi* dhe *Metodologjia*.

4.1. Rezultatet e hulumtimit

4.1.1. Rezultatet e vëzhgimit të pjesëmarrësve dhe mospjesëmarrësve

Kontekstet. Kontekstet e brendshme dhe të jashtme të përdorura për projektin ishin të përshtatshme, ku manastiret, Parku Kombëtar i Butrintit dhe vendet e ngjarjeve kulturore në zonën e Sarandës ishin më interesantet.

Ndërveprimi. Ndërveprimi midis studentëve, studentëve dhe mësuesve, e studentëve dhe objekteve të trashëgimisë ishte i shkëlqyer.

Gjuha angleze. Për sa i përket anglishtes së folur, vëmendja u përqendrua në elementët e ndryshëm gjuhësorë të kompetencave

komunikuese dhe gjuhësore, si shqiptimi dhe intonacioni. Vëzhgimi mundësoi që të kontrollohej procesi i përvetësimit të gjuhës në situata reale, gjë që ndihmoi të hartoheshin aktivitete për ta përmirësuar atë në klasë. Gjithashtu, u qartësuan aspekte pragmatiko-diskursive si llojet e teksteve që nxënësit mund të prodhojnë. U pa se nxënësit mund të prodhojnë dialogë dhe tekste përshkruese. Po kështu, në klasën e 8-të dhe të 9-të ata mund të prodhojnë tekste rrëfyese, përshkruese dhe dialoguese. Në shkollën e mesme dhe në nivel universitar prezantohen tekste që nxisin debatin.

Motivimi .Motivimi është faktor kyç në mësimin e gjuhës. Falë vëzhgimit të pjesëmarrësve, u monitorua motivimi i nxënësve kur dilnin jashtë shkollës, vizitonin mjedisin dhe ndërmerrnin aktivitete në mjedisin mësimor joformal. U vë re se studentët ishin më të motivuar kur bënë veprimtari praktike jashtë klasës.

4.1.2. Rezultatet e fokus- grupit

Ekspertët në fokus- grup e konsideruan projektin inovativ falë përdorimit të trashëgimisë kulturore dhe mjedisit joformal për të mësuar. Kombinimi i perspektivës AIPGJ (Anglishtja e Integruar e Përmbytjes dhe Gjuhës) dhe perspektivës së veprimit u konsiderua gjithashtu risi. Projekti promovon të nxënësit eksperimental dhe kështu u prezantuan mënyra të ndryshme vlerësimi si vlerësimi nga kolegët ose vetëvlerësimi. Motivimi është një tjetër kategori e rëndësishme që tregon rezultate. Studentët ishin shumë të motivuar në projekt. Gjithashtu, ekspertët në fokus- grup, të cilët njohin realitetin e sistemit arsimor shqiptar, e konsideruan projektin të guximshëm, sepse ai sfidon idetë e mësuesve tradicionalë. Fokus grupi sugjeroi modelin e projektit në perspektivën teorike të konstruktivizmit social të kombinuar me të mësuarit eksperimental.

5. Diskutime

Ky projekt ndjek parimet e veprim-kërkimit. Ai është shembull i një propozimi konstruktiv me perspektivë veprimi. Së bashku me disa projekte të tjera ai synon të promovojë AQS-në në arsimin e mesëm dhe në nivelin terciar nëpërmjet përdorimit të mjedisit të trashëgimisë

joformale si kontekst apo burim. Disa përvoja të mëparshme përdorën trashëgiminë si burim ku studentët vepronin si udhërrëfyes turistikë në rajonin e Sarandës, pasi objektivi kryesor i projektit ishte promovimi i aftësive komunikuese në anglishten në turizëm.

6. Përfundime

Ky projekt u zhvillua në Filialin Sarandë dhe u zbatua në shkollat e Sarandës. Qëllimi i projektit është të promovojë të folurin në anglisht duke kombinuar mësimin e gjuhës së folur, mjedisin joformal dhe përdorimin e trashëgimisë kulturore si burim. Të mësuarit jashtë klasës ofron përvojat e nevojshme për të prodhuar gjuhë të folur dhe nxit dialog krijues midis nxënësve dhe mësuesve.

Qëllimi i projektit “për ta çuar shkollën jashtë dhe sjellë botën brenda shkollës” u përmbush. Qëllimet e projektit për ndërtimin e identitetit kulturor të studentëve dhe zhvillimin e kompetencave kulturore u arritën gjithashtu, sepse këto përmbajtje ose kontekste nuk arrihen gjithmonë nga familjet për shkak të faktorëve të ndryshëm (mungesa e njohurive, kombësisë, burimeve ose trajnimit). Propozimi shtrihet midis zonave formale si klasa dhe atyre joformale, si muzetë, vendet, ndërtesat historike, vendet arkeologjike etj. Gjithashtu, ai promovon shije dhe vlerësim për artin, krijimtarinë dhe trashëgiminë kulturore. Së fundmi, të ushtruarit e të folurit në AQS përmes një qasjeje dialoguese ofron përvoja emocionuese për të promovuar oratorinë.

Rezultatet tregojnë rëndësinë e motivimit të studentëve dhe mësuesve në procesin e përvetësimit të AQS dhe si kontekstet joformale kanë ndikim të madh. Fokus- grupi vlerësoi hartimin e projektit i cili teorikisht ishte i përshtatur në konstruktivizmin dhe parimet eksperimentale të Vygotskit dhe e konsideroi atë risi arsimore. Kjo përvojë u vlerësua shumë nga fokus -grupi sepse inkurajon motivimin e studentëve dhe mësuesve duke kombinuar elementë si AQS-në, edukimin e trashëgimisë dhe qasjen ndërkurrikulare.

BIBLIOGRAFIA

- S. ROWE, S. HUMPHRIES. 2012, *The Coombes approach. Learning through an experimental and outdoor curriculum*, Continuum, London.
- L. S. VYGOTSKI. 1986, *Thought and language*, Harvard University Press, Cambridge, M.
- ASENSIO. *El aprendizaje natural, la mejor vía de acercarse al patrimonio*, *Educatio Siglo XXI*, 33 (1), f. 55-82, 2015.
- HUTCHINSON, T & WATERS, A. (1987). *English for Specific Purposes*. New York: Cambridge University Press.
- ROBINSON, P. C. (1991). *ESP Today: A Practitioner's Guide*. New York. Prentice Hall.
- STREVEN, P. (1988). *ESP after twenty years: A re-appraisal*. In M. Tickoo (Ed.), *ESP: State of the art* (f. 1-13). SEAMEO Regional Language Centre. Cambridge University Press.
- DUDLEY-EVANS, T & ST. JOHN, J.M. (1998). *Development in English for Specific Purposes*. Cambridge: Cambridge University Press.
- WALKER, ROBIN. 1995, "Teaching the English of Tourism". *IATEFL ESP SIG Newsletter* no 4. November
- LESLIE, D., & RUSSELL, H. (2006). *The importance of foreign language skills in the tourism sector: A comparative study of student perceptions in the UK and continental Europe*. *Tourism Management*, 27 (6), f.1397-1407.
- SHIEH, W. (2012). *Hotel employees' perception on their workplace English use: An example from Taiwan*. *US-China Foreign Language*, 10(11), f.1729-1733.